



Republika e Kosovës



Komuna Vushtri

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e XI-të (X-të për v. 2010) e Kuvendit Komunal në Vushtri mbajtur më 25.11. 2010

Mbledhja u mbajt në sallën e Kuvendit Komunal duke filluar në orën 10:00. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri, përveç z. Ergyn Sungurit.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: z. Bajram Mulaku, kryetar i Komunës, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të Ministrisë të Administrimit Lokal, përfaqësues të ICO (Zyra Civile Ndërkombëtare), dhe përfaqësues të medieve të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit, i cili fillimisht konstatoi se ekziston shumica për punë dhe vendim të plotfuqishëm.

z. Ferit Idrizi-kryesues i Kuvendit në vazhdim, propozoi që pika 5 dhe 6 e rendit të ditës sipas ftesës të hiqen nga rendi i ditës, pasi që në mungesë të qytetarëve ka dështuar diskutimi publik lidhur me Draft-rregulloret në fjalë. Gjithashtu, propozoi që pikës 8 të rendit të ditës ti shtohen edhe dy propozim-vendime tjera.

z. Bajram Mulaku-paraqiti sqarimet hyrëse lidhur me dy propozim-vendimet e propozuara nga kryesuesi që të futen në rendin e ditës për këtë seancë.

z. Refik Ramaj-pasi përkrahu propozimin e kryesuesit që pika 5 dhe 6 të hiqen nga rendi i ditës, propozoi që si pikë e rendit të ditës të kërkohet informatë nga drejtorja e arsimit, lidhur me atë se pse po tërhiqen nga procesi mësimor nxënësit dhe po përdoren nëpër fushata parazgjedhore si dhe arsimtarët po ftohen nëpër darka të ndryshme në orar të punës.

z. Besim Jashari-duke ju referuar ftesave të dërguara anëtarëve të Kuvendit për shënimin e 28 Nëntorit-Ditës së Flamurit, theksoi se ftesa të tilla është dashtë ti dërgohen edhe përfaqësuesve të biznesit të Komunës së Vushtrrisë duke pasur parasysh kontributin e tyre për zhvillimin ekonomik të Komunës sonë.

znj. Bahrije Pllana-theksoi se rendit të ditës së propozuar i mungon pika e rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e dytë pas diskutimit publik të rregullores për sistematizimin e vendeve të punës (hartues drejtorja e shëndetësisë), paraparë sipas planit të punës të Kuvendit për këtë muaj.

z. Zeqir Hasani-pasi kërkoi nga organet kompetente komunale që të gjendet një lokacion i përshtatshëm për hapjen e Qendrës për regjistrimin e automjeteve në Komunën e Vushtrrisë, theksoi se edhe në rastin e dhënies në

shfrytëzim të pronave të komunës në Stanofc të Poshtëm është dashtë të shkohet me konkurs publik si që propozohet tani në propozim-vendimet e sotme.

z. Bajram Mulaku-theksoi se MPB i kemi ofruar lokal për hapjen e Qendrës për regjistrimin e automjeteve në Vushtrri dhe jemi të gatshëm që një gjë të tillë ta bëjmë edhe në të ardhmen.

Në vazhdim, Kuvendi pas votimit, me shumicë votash "për", aprovoi këtë:

REND DITE

- 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e KK-së mbajtur më 28.10.2010;**
- 2. Shqyrtimi i informatës lidhur me realizimin e të hyrave vetjake buxhetore për muajin tetor 2010;**
- 3. Shqyrtimi i Informatës për legalizim të ndërtimeve pa leje në komunën e Vushtrrisë për periudhën 2002-2010;**
- 4. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për organizimin e punës dhe të mësimit në shkollat e mesme të larta të Komunës së Vushtrrisë (shqyrtimi i parë);**
- 5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim të tokës në pronësi të komunës sipas kërkesës së MPB të Republikës së Kosovës;**
- 6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien me qira të lokaleve afariste pronë e komunës (lokalet para objektit për banim social dhe të lokalit që gjendet te banesat e bardha rr. "Skënderbeu");**
- 7. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të bufesë të komunës;**
- 8. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për dhënien me qira të lokaleve në dy shkolla të MU në qytet;**
- 9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm pa kompensim të zyrave që gjenden në objektin e ish TMK-së, sipas kërkesës së KEK-ut;**

- 1) Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e KK-së mbajtur më 28.10.2010.**

z. Qazim Azemi-në faqe 7 të procesverbalit në diskutimin lidhur me informatën e arsimit tej mase është shkurtuar diskutimi im. Në vazhdim ceku se në mesë tjerash kam thënë se mbi 10000 nxënës të shkollave të mesme dhe fillore nuk e kanë zhvilluar normalisht procesin mësimor. Tenderi për material shpenzues nga drejtoria e arsimit është shpallur pasi ka filluar procesi mësimor si dhe në shkollën fillore "Çajupi" procesi mësimor nuk ka filluar me kohë, ka filluar me datë 27 shtator. Sa i përket regjistrimit të nxënësve në shkolla të mesme, po i jepet përparësi gjimnazit që po shkon në dëm të shkollave tjera të mesme profesionale. Në fund propozoi që për lëshimet e cekura procesmbajtësit ti jepet vërejtja e fundit ose të ndërrohet i njëjti.

z. Ismet Gashi-faqe 6, te pika 7 ku thuhet: "nëse aprovohet ky vendim drejtoria gjegjëse nuk mund të regjistrohet...", duhet të jetë:"nëse ky vendim aprovohet drejtoria gjegjëse nuk mund të bëjë regjistrimin..."

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit, njëzëri, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Aprovohet procesverbali nga mbledhja e rregullt e KK-së, mbajtur me 28.10.2010, me vërejtjet e paraqitura nga ana e anëtarëve të Kuvendit.

2) Shqyrtimi i informatës lidhur me realizimin e të hyrave vetjake buxhetore për muajin tetor 2010.

z. Zeqir Hasani-pasi ceku se kemi rënie prej 33% të hyrave vetjake buxhetore për muajin tetor 2010 krahasuar me muajt tjerë, kërkoi angazhim të drejtorive komunale kompetente në mënyrë që të rritet inkasomi i të hyrave buxhetore të komunës dhe atë jo vetëm në disa pozicione (tatim në pronë dhe taksë në firmë), por edhe në pozicionet tjera. Në fund kërkoi nga drejtoria kompetente që të ofroj një tabelë për kryerjen e obligimeve të tatimit në pronë sipas lokaliteteve (fshatrave dhe bashkësive lokale) dhe listën e projekteve të realizuara në këto lokalitete.

z. Besim Jashari-kryetari i Komunës ka thënë se nuk është i kënaqur me realizimin e të hyrave vetjake buxhetore, nëse është ashtu, atëherë pse nuk kemi llogaridhënie nga ana e organeve kompetente përgjegjëse. Në vazhdim ceku se në faqe 2 të informatës, indekset e paraqitur nuk janë real, si dhe ceku se nuk kemi realizim të hyrave nga inspektimi i ambientit, nga reklamat e vendosura në pronë të komunës, nga taksat për leje etj.

z. Pajazit Pllana-kërkoi sqarim lidhur me rënien e të hyrave vetjake nga participimi në shëndetësi dhe nga regjistrimi i automjeteve.

z. Safet Idrizi-duke u përgjigjur në pyetjen e parashtruar nga z. Pllana theksoi se arsyeja e rënies së participimit në shëndetësi është se në gjashtëmujorin e dytë të këtij viti nuk jemi duke lëshuar certifikata mjekësore për patentë shofer.

z. Bajram Mulaku-pasi ceku se jemi të angazhuar maksimalisht në realizimin e të hyrave vetjake buxhetore, theksoi se sa i përket tatimit në pronë dhe taksës në firmë kemi realizim të kënaqshëm të hyrave ndërsa në të hyrat tjera kemi ngecje.

z. Refik Ramaj-theksoi se indekset në informatën në fjalë janë paraqitur gabimisht duke paraqitur shembuj konkret për këtë.

z. Veli Karaça-ne në çdo mbledhje të Kuvendit shqyrtojmë informatë lidhur me atë se sa i përgjigjen qytetarët obligimeve ndaj pushtetit, ndërsa nuk shqyrtojmë çështjen se sa pushteti ju ofron shërbime qytetarëve ose çfarë shërbime ju ofron qytetarëve.

3) Shqyrtimi i Informatës për legalizim të ndërtimeve pa leje në Komunën e Vushtrrisë për periudhën 2002-2010.

z. Ismet Gashi-pasi ceku se është mirë që është kërkuar një informatë e tillë, theksoi se përvojat e komunës së Prishtinës në këtë lëmi është dashtë të jetë bashkangjitur si shkresë e veçantë kësaj informate, e jo të jetë pjesë e informatës. Në fund pyeti se sa mund të zbatohet Rregullorja për legalizim të objekteve të ndërtuara pa leje (pasi që e njëjta ende është në fuqi), nga momenti i aprovimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe Urban në vitin 2009.

z. Muharrem Shabani-pasi ceku se është mirë të merren përvojat e komunave tjera e posaçërisht të Komunës së Prishtinës, theksoi se ne kemi miratuar rregulloren në fjalë por kemi çaluar në zbatimin e saj.

4) Shqyrtimi i Draft-Rregullores për organizimin e punës dhe të mësimit në shkollat e mesme të larta të Komunës së Vushtrrisë.

znj. Vlora Qirezi-paraqiti këto vërejtje dhe propozime për plotësim:

Neni 6.10, duhet të konkretizohet pasi që në formën e paraqitur nuk është i qartë;

Nuk është në rregull që nxënësi të bëjë pagesë për marrjen e një vërtetimi nëse i nevojitet si është propozuar;

Mendojmë që me një nenë të veçantë duhet të përcaktohet lirimi nga pagesa e nxënësve të familjeve në asistencë sociale si dhe të nxënësve të familjeve të shoqatave të dala nga lufta, por duhet të përcaktohet se çfarë dëshmie duhet të paraqesin këta nxënës;

Neni 8, propozojmë të ceket procedura për iniciimin e përgjegjësive dhe shqiptimin e masave disiplinore për nxënës;

Në fund rregullorja në fjalë duhet të përmbaj edhe dispozitat kalimtare dhe përfundimtare.

z. Qazim Azemi- paraqiti këto vërejtje dhe propozime për plotësim:

Neni 4 ti shtohet një paragraf për mësim joformal;

Neni 5 ti shtohet se nxënësit kanë të drejt të ndërrojnë klasën me pëlqim të organeve kompetente;

Neni 8 ti shtohen masat edukative për nxënës;

Neni 12 ti shtohet që kujdestarit të klasës mund ti merret klasa nëse nuk i kryen si duhet punët si dhe që për punën e tyre të paguhen kujdestarët e klasave;

Neni 16 është i përgjithësuar, të precizohet;

Detyrat e këshillit të shkollës dhe të nxënësve nuk janë dhënë, duhet të precizohen;

Rregullores në fjalë i mungon një nen në të cilin do të ceket roli i prindërve, fuqizimi i rolit të prindërve;

z. Esat Beka- paraqiti këto vërejtje dhe propozime për plotësim:

Neni 6.10, të lirohen nga pagesa nxënësit e familjeve të shoqatave të dala nga lufta;

Neni 7.15, të ndalohet përdorimi i telefonave në tërë objektin e shkollës.

z. Sabit Kadriu-pasi ceku se në parim rregullorja është paraqitur mirë, theksoi se në disa raste rregullorja bazohet në Udhëzimet Administrative ndërsa në disa raste nuk i përmbahet, duke marr si shembull rastin e mos pensionimit të arsimtarëve gjatë vitit shkollor si që parasheh Udhëzimi Administrativ. Në disa raste kemi përsëritje të fjalive të njëjta si te nenet 5.5 dhe 5.13, 12.6 dhe 12.7 etj.

Përkrahu propozimin që kujdestarët e klasave të paguhen për punën e tyre dhe kjo të ceket në rregullore.

Neni 6 duhet të përmbaj saktë obligimet dhe përgjegjësitet e nxënësve. Në fund propozoi që rregullorja të përmbaj edhe masën e para përjashtimit të nxënësve si masë disiplinore dhe në raste të veçanta edhe largimin nga shkolla.

z. Pajazit Pllana-pasi ceku se në parim përkrah draft-rregulloren në fjalë, theksoi për të pasur një proces të mirë mësimor nevojitet të kemi në shkollat e mesme psikolog, mjek të mjekësisë familjare dhe stomatolog.

z. Muharrem Shabani- pasi ceku se draft-rregullorja në fjalë i mungojnë dispozitat përfundimtare, theksoi se duhet të fuqizohet roli i këshillit të prindërve dhe këtë duhet ta përmbaj rregullorja.

Në fund kërkoi që lidhur me këtë draft-rregullore por edhe në raste tjera të kemi një diskutim publik të mirëfilltë.

z. Ferit Idrizi-fillimisht sa i përket diskutimit publik kërkoi nga kompetentët që të ftojne drejtorët e shkollave të mesme dhe profesorët.

Neni 5.3 dhe 5.7 propozoi të hiqet, ndërsa neni 5.6 të korrigjohet pasi që nxënësi nuk mund të marr dokumentacionin pedagogjik.

Neni 5.15, ti shtohet se nxënësi ka të drejt të kërkoi që të vlerësohet nga një komision profesional në raste të caktuara

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit, njëzëri, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Ipet në diskutim publik Draft-Rregullorja për organizimin e punës dhe të mësimin në shkollat e mesme të larta në territorin e Komunës së Vushtrrisë. Diskutimi publik zgjatë nga data 26.11.2010 deri 20.12.2010.

5). Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim të tokës në pronësi të komunës sipas kërkesës së MPB të Republikës së Kosovës;

z. Veli Karaça-pasi ceku se në KPF-ca kemi kërkuar që të kemi kërkesën e MPB, gjegjësisht të QKSPZH në Vushtrri, theksoi se kërkesa në fjalë e cila është paraqitur me vonesë nuk është e argumentuar. Në fund propozoi që qendrës në fjalë ti epet në shfrytëzim për këtë qëllim një parcelë në periferi të qytetit e jo parcela e propozuar pasi që komuna ka nevojë për këtë parcelë si dhe nëse i epet në shfrytëzim atëherë ti epet pa pagesë.

z. Nezir Klinaku-paraqiti sqarimet hyrëse duke theksuar se kemi të bëjmë me dhënien në shfrytëzim të përkohshëm dhe në këtë mënyrë nuk bëhet ndërrimi i titullarit. Sa i përket formës së dhënies në shfrytëzim, me pagesë apo pa pagesë, ne kemi propozuar të epet në shfrytëzim me pagesë, ndërsa Kuvendi është ai që vendos.

z. Sami Istrefi-pasi ceku se përkrahë propozim-vendimin në fjalë, propozoi që afati i dhënies në shfrytëzim të jetë për tri vite me mundësi vazhdimi.

z. Zeqir Hasani-grupi parlamentar i AAK-së nuk mbështet propozim-vendimin në fjalë pasi që parcela e propozuar për dhënie në shfrytëzim në të ardhmen do ti nevojitet komunës së Vushtrrisë.

z. Sabit Kadriu-nëse vazhdojmë në këtë mënyrë të japim pronën e komunës në shfrytëzim atëherë së shpejti komuna do të mbetet fare pa pronë. Sa i përket propozim-vendimit në fjalë mendoj se për trajnimet e tilla është e logjikshme të caktohen lokacione në periferi të qytetit e jo si është propozuar në qendër të qytetit.

z. Qazim Azemi-kërkoj që lidhur me kërkesën në fjalë të kemi informacione shtesë, pasi që kërkesa e paraqitur nuk ofron të dhëna të mjaftueshme në bazë të cilave do të mundemi të vlerësojmë arsyeshmërin e kërkesës.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit, me shumicë votash, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Propozim-vendimi për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të pronës komunale në bazë të kërkesës të MPB, gjegjësisht QKSPEZH i kthehet propozuesit për shkak se i njëjti nuk është i argumentuar, gjegjësisht në kërkesën e paraqitur nga MPB-QKSPEZH nuk është precizuar vlera e investimeve, sipërfaqja e cila kërkohet, si dhe afati kohor për të cilin kërkohet dhënia në shfrytëzim e pronës komunale.

Andaj, nga propozuesi gjegjësisht kërkuesi (QKSPEZH), kërkohet që në kërkesë të paraqiten të dhënat e nevojshme të cekura më lartë para se

propozim-vendimi përsëri të procedohet për shqyrtim në Kuvendin e Komunës.

Në vazhdim, në propozim të kryesuesit, kuvendi vendosi që pika 6,7 dhe 8 të rendit të ditës të shqyrtohen së bashku duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me propozim-vendime të ngjashme.

6). Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien me qira të lokaleve afariste pronë e komunës (lokalet para objektit për banim social dhe të lokalit që gjendet te banesat e bardha rr."Skënderbeu");

7).Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të bufësë të komunës;

8).Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për dhënien me qira të lokaleve në dy shkolla të MU në qytet;

z. Ferit Idrizi-propozoi që dhënia në shfrytëzim të përkohshëm me qira të bufeve të shkollave të bëhet përmes shpalljes së konkursit publik.

z. Ismet Gashi-pasi përkrahu propozimin e kryesuesit, propozoi që dhënia në shfrytëzim të përkohshëm të lokaleve-bufeve të shkollave të bëhet pa pagesën e qirasë ashtu si është propozuar për bufen e komunës. Me rastin e dhënie në shfrytëzim të këtyre lokaleve-bufeve të merret parasysh fakti se kush ofron çmime më të ulëta për shërbime të ofruara.

Kuvendi, pas votimit, njëzëri, përkrahu propozimet e lartcekura të z. Idrizi dhe Gashi.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit, me shumicë votash, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Lejohet shpallja e konkursit për dhënien me qira të lokaleve pronë e komunës së Vushtrrisë, të cilat gjenden afër qendrës së banimit social, rruga "Jeton Terstena" në Vushtri. Në këtë lokacion gjenden 5 lokale:

- Lokali nr.1 me sipërfaqe prej 16m²**
- Lokali nr.3 me sipërfaqe prej 11m²**
- Lokali nr.5 me sipërfaqe prej 11m²**
- Lokali nr.5 me sipërfaqe prej 11m²**
- Lokali nr.7 me sipërfaqe prej 21m²**

Lejohet shpallja e konkursit për dhënien me qira të lokalit pronë e komunës së Vushtrrisë në sipërfaqe prej 98m², pjesë e parcelës kadastrale nr.2384, fletë poseduese nr.45 i cili gjendet në rrugën "GJ. K. Skënderbeu" në Vushtri.

Ipet në shfrytëzim të përkohshëm në kohëzgjatje prej 2 vitesh me mundësi vazhdimi, lokali nr. 15 i cili gjendet në objektin e administratës komunale si dhe lokali në drejtorin për urbanizëm dhe mbrojtje të ambientit në sipërfaqe prej 3m².

Lokalet në fjalë destinohen për bufe për nevoja të organeve të komunës dhe personelit të komunës dhe ipen në shfrytëzim pa kompensim.

Lejohet shpallja e konkursit për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të lokaleve pronë e shkollave të mesme të ulët të cilat gjenden:

- SHMU 1 përballë ish Kooperativës Bujqësore në Vushtri**
- SHMU 2 afër Stacionit Policor në Vushtri**

Lokalet e cekura ipen në shfrytëzim të përkohshëm pa kompensim në kohëzgjatje prej 2 vitesh me mundësi vazhdimi me destinim-mini restorant për nevoja të nxënësve të këtyre shkollave.

9).Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm pa kompensim të zyrave që gjenden në objektin e ish TMK-së, sipas kërkesës së KEK-ut;

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit, me shumicë votash, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

KEK-Njësia në Vushtrri, i lejohej për shfrytëzim një pjesë e ish objektit të TMK-së në katin përdhes në sipërfaqe prej 111m² dhe hapësira para këtij objekti në sipërfaqe prej 100m², pjesë e parcelës kadastrale nr.23581, fleta poseduese nr.45, ZK-le Vushtrri, pronë e Komunës së Vushtrrisë

Patundshmëria e cekur më lartë ipet në shfrytëzim të përkohshëm pa kompensim për vendosjen e stafit të punëtorëve të KEK-Njësia në Vushtrri, në afat prej 1 viti.

Pyetjet e Anëtarëve të Kuvendit

z. Pajazit Pllana-pasi pyeti drejtorin e Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim dhe Kryetarin i Komunës se a është e vërtetë që çmimi i bukës në Vushtrri është 40 cent ndërsa në Prishtinë 25 cent, kërkoi sqarime se kush ka mundësuar këtë, gjegjësisht çfarë kriteresh janë përdorur me rastin e caktimit të çmimit të bukës sipas të cilit çmimi i bukës në Vushtrri të jetë më i lartë se në Prishtinë.

z. Qazim Azemi-fillimisht kërkoi përgjigje se pse nuk po jepen përgjigje në pyetjet e parashtruara nga ana e anëtarëve të Kuvendit duke marr si shembull pyetjen e znj. Makfirete Ademi për të cilën nuk ka marr ende përgjigje.

Në vazhdim kërkoi që të ndërpritet praktika e keqpërdorimit të automjeteve zyrtare të komunës për nevoja të fushatës parazgjedhore, pasi që jemi dëshmitar që këtyre ditëve kjo po ndodhë.

Në fund theksoi se përderisa arsimtarët po ftohen nëpër darka të ndryshme, nëpër shkolla tona procesi mësimor po zhvillohet në kushte të këqija.

z. Ferit Idrizi-kërkoi nga anëtarët e Kuvendit që pyetjet të parashtrohen në formë të shkruar në mënyrë që Sekretaria e Kuvendit të mund ti procedoj më lehtë deri te organet kompetente për të dhënë përgjigje.

znj. Gjylsime Feka-në rrugën "Drenica" dhe "Lutfi Musiqi" nuk funksionon fare ndriçimi publik që paraqet probleme të ndryshme gjatë natës duke marr parasysh frekuentimin e këtyre rrugëve. Gjithashtu, në këto rrugë ka nevojë të vendosen pengesa në rrugë (polic të shtrirë), në mënyrë që të shtohet siguria e nxënësve dhe kalimtarëve tjerë. Prandaj, kërkoi nga drejtoria për Shërbime Publike që të bëhet rregullimi i ndriçimit publik dhe vendosja e pengesave në rrugët në fjalë.

z. Refik Ramaj-ripërsëriti pyetjen që bëri në fillim të seancës që sipas tij paksa u banalizua lidhur me darkat dhe ndërprerjen e procesit mësimor. Në fakt pyetja ishte pse nuk po organizohen darkat për arsimtar jashtë orarit të mësimit, në mënyrë që nxënësit të mos humbin orët e mësimit, kjo ishte pyetja e jo pse po organizohen darkat në fjalë.

z. Veli Karaça-disa herë kam shprehur shqetësimin lidhur me shfrytëzimin e pa autorizuar të lokaleve dhe pronës komunale nga ana personave të ndryshëm. Asnjëherë nuk kemi marr informatë lidhur me atë se kush i shfrytëzon lokalet e ndryshme që janë pronë e komunës prej të cilëve Komuna mund të inkasoj të hyra, pasi që kemi krijuar bindjen se këto lokale

po shfrytëzohen me lejen e dikujt . Uzurpimi dhe shfrytëzimi i pa autorizuar i pronës dhe lokaleve në pronësi të komunës duhet të jetë preokupim i këtij Kuvendi, prandaj kërkoi informatë lidhur me atë se kush po e shfrytëzon pronën komunës (lokalet) e të cilët nuk paguajnë taksën e nevojshme për shfrytëzim.

z. Sabit Kadriu-kërkoi që të instalohet aparatura për incizim (mikrofonat) para ulëseve të anëtarëve të Kuvendit në mënyrë që anëtarët e Kuvendit të mos kenë nevojë të përdorin foltoren e Kuvendit për çdo diskutim të tyre.

Mbledhja përfundoi në **ora 14:15**

Procesmbajtësi:
Ilmi Zeqiri

Kryesuesi i Kuvendit
Ferit Idrizi